se i Dërguari i Allahut në sexhde thoshte: “O Allah, m'i fal të gjitha mëkatet: të vogla e të mëdha, të kaluara e të ardhme, të bëra haptas dhe ato fshehtas!”

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut në sexhde thoshte: “O Allah, m'i fal të gjitha mëkatet: të vogla e të mëdha, të kaluara e të ardhme, të bëra haptas dhe ato fshehtas!”
[Sahih] [Transmeton Muslimi]

Profeti e bënte këtë lutje gjatë sexhdes së tij: “O Allah, m'i fal të gjitha mëkatet", duke i fshehur ato, dhe më mbro nga pasojat e tyre përmes faljes, neglizhencës dhe mëshirës. "të gjitha", d.m.th.: ato që janë "të vogla", pra të pakta dhe të lehta, "e të mëdha", të shumta dhe të rënda; mëkate "të kaluara e të ardhme", dhe ato që janë në mes tyre; "të bëra haptas dhe ato fshehtas!”, të cilat nuk i di askush tjetër përveç Teje, o Ti i Lartësuar.

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/5470